



Trajneri i ri i skuadres tetovare Shkendija, ka nisur punen e tij te re. Shpetim Duro eshte prezantuar me skuadren dhe me mediat vendore dhe pasi ka thene fjalen e tij te pare ka filluar stervitjen per te pergatitur takimin e rradhes. Duro do te drejtoje provizorisht skuadren tetovare ne tre ndeshjet e mbetura dhe ne janar pritet te nenshkruaj nje kontrate afatgjate. “Jam i lumtur qe mu dha rasti te drejtoj kete skuader. Eshte nje eksperience e re per mua dhe do ta shfrytezoj per te bere me te miren me kete skuader te cilen e kam pare dhe e njoh ashtu si njoh mjaft mire edhe futbollin maqedonas”, ka thene shkurtimisht Shpetim Duro.